



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 155, Datë 07.10.2020

“MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “MATEO & CO” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “MURASI” ME KAPACITET
TË INSTALUAR 2000 KW, NË LUMIN E CEMIT TË SELCËS, DEGË E LUMIT CEM I
BASHKUAR, NË BASHKINË MALËSI E MADHE, QARKU SHKODËR.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 109, datë 29.06.2016, dhe nenit 15 të “Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 07.10.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes nr. 105/1 prot, datë 23.09.2020, mbi licencimin e shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 144, datë 28.08.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Murasi”, me kapacitet prodhues 2000 kW, në lumin e Cemit të Selcës, degë e lumit Cem i Bashkuar, në Bashkinë Malësi e Madhe, Qarku Shkodër, për një afat 30-vjeçar.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 62/27 prot, datë 28.08.2020 dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k.
- Me shkresën nr. 1053/2 prot, datë 01.09.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit.
- Me shkresën nr. 52 prot, datë 17.09.2002, protokolluar në ERE me nr. 1053/4 prot, datë 17.09.2020, shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k., ka depozituar në ERE dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k, është regjistruar pranë QKB-së në datën 20.05.2016, konform Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit ” (QKB), me formë ligjore Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
- Shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k. ka depozituar në ERE Kontratën nr. 1768 REP, nr. 784/3 KOL, datë 26.07.2017, “Kontratë për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Murasi” me kapacitet prodhues 2 MW, në lumin e Cemit të Selcës, degë e lumit Cem i Bashkur, në Bashkinë Malësi e Madhe, Qarku Shkodër, e lidhur midis MIE-s dhe Mbajtësit të miratimit, shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k..
- Shoqëria ka depozituar në ERE Raportin e oponencës teknike të AKBN-së nr. 2572 Prot, datë 20.03.2017, mbi projektin e zbatimit të HEC-it “Muras” miratuar nga MIE me Miratimin përfundimtar nr. 3719/13, datë 13.07.2017, “Për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë, hidrocentralit “Murasi”, në lumin e Cemit të Selcës, Qarku Shkodër”.
- Shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k., ka përcjellë në ERE shkresën e OSHEE sh.a. 27446/2 prot, datë 21.11.2016, “Miratim pikë lidhje”, drejtuar shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k., ku përcaktohet se HEC-i, do të lidhet me rrjetin shpërndarës në linjës 35 kv, të n/stacionit Tamarë.
- Shoqëria ka paraqitur “Leje për përdorim të burimit ujqor” me nr. serie 00050, nr. 179/10 prot, datë 20.04.2017, të miratuar nga KBU Drin-Bunë, me Vendimin nr. 11, datë 10.04.2017, për shoqërinë “MATEO & CO” sh.p.k. me qëllim ndërtimin e HEC “Murasi”, duke përdorur burimin ujqor Lumin Cemi i Selcës, degë e Lumit Cemi i Bashkuar.
- Shoqëria ka përcjellë në ERE VNM paraprake lëshuar nga Agjensia Kombëtare e Mjedisit, me nr. 2829 Prot, datë 02.12.2016 dhe nr. 712 Identifikimi dhe nr. 59 vendimi, për Personin juridik “MATEO & CO” sh.p.k., “Për të zhvilluar projektin “Ndërtim-operim i HEC “Murasi” me kapacitet 2000 kW.
- Duke qenë se afati i vlefshmërisë së lejes së ujqit me nr. serie 00050, nr. 179/10 prot, datë 20.04.2017, të miratuar nga KBU Drin-Bunë, me Vendimin nr. 11, datë 10.04.2017, për shoqërinë “MATEO & CO” sh.p.k., është deri më 09.04.2022, do t’i kërkohet shoqërisë që të depozitojë në ERE lejen e ujqit të rinovuar, pas përfundimit të afatit sipërcituar.
- Duke qenë se afati i vlefshmërisë së kontratës së qirasë, me nr. 6418 prot, datë 08.10.2018, të nënshkruar midis Bashkisë Malësi e Madhe, në cilësinë e qiradhënësit, dhe shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k. në cilësinë e qiramarrësit, përfundon në datën 08.10.2023, do t’i kërkohet shoqërisë në vijim që, pas rinovimit, të përcjellë në ERE kontratën e rinovuar.

Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k., rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht kërkesat e “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim. Neni 9, pika 1, gërmat a), b) c). **plotësuar**
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2, gërmat a), b), c), d), e), f) g). **plotësuar**

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3, gërmat a), b), c) d). **plotësuar**. Shoqëria ka kryer financimin e veprës pjesërisht me të ardhurat e e shoqërisë dhe një pjesë me kredi bankare.
- Dokumentacioni teknik për HEC-in. Neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3, gërmat a), b), c), d) dhe pika 4.1.4, gërmat a), b), c), d), e). **plotësuar**.
- Leje nga institucione të tjera. Neni 9, pika 4.1.5, gërmat a), b), c). **plotësuar**.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “MATEO & CO” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Murasi”, me kapacitet prodhues 2000 kW, në lumin e Cemit të Selcës, degë e lumit Cem i Bashkuar, në Bashkinë Malësi e Madhe, Qarku Shkodër, për një afat 30-vjeçar.
2. Shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k., të bëjë me dije ERE-n mbi ecurinë e procesit të rinovimit si dhe të depozitojë në ERE çdo dokument/leje që i nënshtrohet procedurës së rinovimit, jo më vonë se 1 muaj pas rinovimit të tyre.
3. Mos plotësimi i kushtit të parashikuar në pikën 2 të këtij vendim përbën shkak për rishikimin e vendimit nga ERE.
4. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI